

LIRITË RELIGJIOZE

LIRIA E MENDIMIT, E NDËRGJEGJES DHE E BESIMIT

LIRIA PËR TË PRANUAR DHE NDËRRUAR RELIGJIONIN OSE BESIMIN,

LIRIA PËR T'I MANIFESTUAR KËTO TË DREJTA

>>Çdokush ka të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes dhe të besimit; kjo e drejtë përfshin lirinë e ndërrimit të besimit apo të bindjeve dhe lirinë që njeriu, qoftë vetë ose në bashkësi me të tjerët, të shfaqë publikisht ose privatisht besimin apo bindjen e vet me anë të dhënies së mësimëve, kryerjes së kultit dhe riteve fetare.<<

Neni 18, DEKLARATA UNIVERSALE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

TREGIMI ILUSTRUES

I burgosuri 38 vjeçar Turkmen Kristian Shageldi Atakov, i tha lamtumirë gruas së tij Artygyl me rastin kur asaj iu lejua ta vizitojnë atë në burgun Seidi, një kamp pune në Turkmenistanin verilindor. Atakov i tha gruas së tij se nuk ia merrte mendja se do të mbijetonte trajtimin brutal fizik të cilin po e përjetonte aty.

Në kohën kur ajo e vizitoi atë, ai kishte hematome dhe ishte i rrahur, kishte dhimbje në veshka dhe në mushkëri dhe vuante nga verdhëza. Ai mezi ecte dhe shpesh humbte vetëdijen.

Para se ta arrestonin më 18 dhjetor të vitit 1998 në shtëpinë e tij, Atakovi ishte kërcënuar dy herë nga zyrtarët shtetëror që t'i ndërpresë predikimet dhe pjesëmarrjen në kishën e tij, për një grumbullim të paregjistruar Evangjelist të Krishterëve Baptisët.

Pasi që një muaj më herët një polic i kishte bërë vërejtje fshehurazi, , një javë para se ta arrestonin, një udhëheqës i lartë mysliman, së bashku me një përfaqësues të komitetit lokal për çështje fetare, shkoi në shtëpinë e tij për t'ia përsëritur se nëse do të vazhdonte kështu, ai mund të përballej me “akuza ligjore”.

Tre muaj pas arrestimit, Atakovi u dënua me dy vjet burg. Mirëpo, në mars të vitit 1999, prokurori parashtrroi ankesë për shkak se dënimi ishte “shumë i butë”.

Shtatë muaj më vonë, gjatë kohës së rigjykimit të tij ai ishte rrahur aq shumë, sa që i kishte lutur fëmijët e tij të mos e preknin sepse kishte dhimbje të mëdha.

Në muajin shkurt të vitit të kaluar, gruaja e Atakovit dhe pesë fëmijët e tyre janë përndjekur nga shtëpia e tyre në Meri, në azil të brendshëm në Kahka, ku ende vazhdojnë të jetojnë në “arrest fshatar”.

Urdhërat sekrete të policisë erdhën pasi që gruaja e tij refuzoi t’i lejojë fëmijët e saj të përkulen para fotografisë së presidentit, gjatë ritualit të përditshëm në shkollat publike.

(Ky incident është raportuar pranë një OJQ-je evropiane, e cila ka qëllim promovimin e demokracisë, sundimit të ligjit dhe të drejtave individëve në gjithë botën. Raportimi për këtë rast ende nuk është vazhduar.)

Marrë nga përmbajtja e raportit: Human Rights Without Frontiers, available at: <http://www.hrwf.net/newhrwf/html/tukey2001.html>, October 2002

PYETJET PËR DISKUTIM

1. Çka mendoni, cilat janë arsyet për trajtimin e tillë të Z. Atakov?
2. Çka mendoni se mund të bëhet për të parandaluar përsëritjen e situatave të tilla? A keni njohuri për ndonjë sistem ekzistues për mbrojtje?
3. A keni dëgjuar për incidente të ngjashme në vendin tuaj?

>>Asnjë njeri nga natyra nuk është i betuar ndonjë kishë të caktuar ose ndonjë sekti, por çdokush i bashkohet vullnetarisht atij grupi në të cilin ai beson se ka gjetur adhurimin dhe manifestimin e vërtetë dhe të pranueshëm për Zotin. Arsyeja e vetme e bashkangjities së tij, është shpresa për shpëtim, prandaj është edhe arsyeja e vetme për qëndruar aty . . . Atëherë, kisha është një shoqëri e anëtarëve të bashkangjitur vullnetarisht për atë qëllim.<<

XHON LLOKU (JOHN LOCKE), LETRA PËR TOLENRACË, 1689

E DOMOSDOSHME TË DIHET

1. LIRITË RELIGJIOZE: NJË RRUGË E GJATË E CILA KA MBETUR ENDE PËR T’U UDHËTUAR

Miliona njerëz besojnë se ekziston diçka mbinjerëzore që na udhëheq shpirtërisht. Ndosht që për shkak të asaj në çka besoni, të detyrohëni ta mohoni atë besim, ta braktisni familjen, të ndiqeni, burgoseni ose edhe të vriteni.

Gjatë shekullit të III të erës së re, në Indi budistët u persekutuan për shkak se besonin në mësimet e Budës. Duke filluar nga shekulli IX, në periudhën e njohur si “Vitet e Errëta” të Evropës, besimtarët mysliman dhe jokrishterë u persekutuan “në emër të Zotit”. Më pas, lufta për zgjerimin e Perandorisë Osmane dhe përhapjen e besimit islam e tmerroi Evropën. Hebrenjtë u mbyllën nëpër geto, jo vetëm nga të krishterët por edhe nga myslimanët. Gjithashtu, gjatë procesit të përhapjes së krishterimit u bë zhdukja e indianëve të Amerikës Latine.

Sikurse në të kaluarën, edhe tani, njerëz të ndryshëm religjiozë dhe joreligjiozë janë të kërcënuar për shkak se besojnë ose nuk besojnë në diçka. Aftësia për të besuar në diçka dhe për ta shfaqur atë besim, njihet dhe mbrohet si liri religjioze dhe kjo nuk është vetëm çështje ligjore por edhe morale. Besimi fetar ndërhyr thellë në jetën private të njeriut, sepse prek bindjet dhe kuptimet personale mbi botën tonë.

Feja është një ndër elementet kryesore për të shprehur identitetin kulturor të njeriut, prandaj kjo edhe është arsyeja pse liritë fetare janë tema mjaft të ndieshme për t’u adresuar dhe duket se shkaktojnë më shumë probleme sesa çështjet e tjera të të drejtave të njeriut.

Një tjetër problem e ka penguar rregullimin e lirive religjioze në kuadër të të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Religjioni dhe besimi janë elemente kyçe të politikës dhe të politikanëve, në gjithë botën. Liritë dhe besimet religjioze shpesh keqpërdoren për kërkesa politike dhe pretendime të pushtetit, me ç’rast, shpesh, kur religjioni dhe politika janë të ndërlidhura rezultohen argumente të gabuara.

Pasi që në gjithë botën jotoleranca dhe persekutimi religjioz janë duke u paraprirë shumë konflikteve tragjike që përfshijnë probleme etnike, racore dhe të urrejtjes ndaj grupeve të caktuara, gjatë viteve të fundit është bërë mjaft aktuale ofrimi i mbrojtjes adekuate. Në konfliktet e kohës së sotme në shtetet multireligjioze, ose brenda shtetit, mund të shihen perskutime mbi baza religjioze si mes besimtarëve dhe jobesimtarëve, religjioneve tradicionale dhe atyre të “reja”, mes një religjioni zyrtar ose të preferuar dhe individëve ose bashkësive që nuk i takojnë atij religjioni.

Sot, shkeljet e lirive religjioze shfaqen, që nga ndalimi i besimeve të ndryshme në Kinë, “spastrimi etnik” ndaj myslimanëve edhe të krishterëve në Bosnjë dhe Kosovë, tensionet

në Irlandën Veriore, e deri te ndarjet religjioze të kufijve në Saharën Jugore, nga Etiopia deri në Nigeri, dhe vrasjet me motive religjioze. Këto shkelje shfaqen që nga rritja e ndikimit të religjionit në konfliktin mes Indisë dhe Pakistanit, ose mes hinduve dhe myslimanëve, i cili tani ka arritur në kërcënim me armatim nuklear, e deri te shfaqja e ekstremizmit religjioz tek islamizmi dhe së fundi është rritja e ndjenjave antiislamike në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në Evropë.

Fatëkeqësisht, ekzitojnë edhe shumë raste të tjera që theksojnë domosdoshmërinë e trajtimit të lirive religjioze, e në veçanti të atyre që janë të lidhura me ekstremizmin. Megjithatë, ky fenomen duhet të adresohet ndaras.

🙏 E domosdoshme të dihet

Liritë religjioze dhe siguria njerëzore

Liria nga frika është vlera themelore e sigurisë njerëzore. Kjo vlerë themelore është duke u rrezikuar pa masë nga shkeljet e lirive religjioze. Në qoftë se një person nuk mund të besojë në çfarëdo “Zoti” ose koncept tjetër për universin të cilin vetë e preferon, atëherë liria dhe siguria personale do ta jenë larg realizimit. Kërcënimet ndaj lirisë së mendimit, ndërgjegjes, besimit dhe religjionit të individëve dhe grupeve të njerëzve ndikojnë drejtpërdrejt në sigurimin dhe zhvillimin e integritetit të tyre personal.

Kur diskriminimi dhe persekutimi mbi baza religjioze është sistematik dhe i institucionalizuar, ai mund të rezultojë me tensione mes bashkësive e madje edhe në kriza ndërkombëtare. Shkaktarë të pasigurisë mund të jenë të gjithë - individët, grupet, por edhe shtetet. Kjo kanosje e plotfuqishme dhe e gjithëpranishme ndaj sigurisë personale, e bazur në besim ose religjion, kërkon masa të posaçme mbrojtëse. Arsimimi dhe mësimi për të drejtat e njeriut paraqet bazë për krijimin e respektit ndaj mendimeve dhe besimeve religjioze të të tjerëve. Mësimi për respektin, tolerancën dhe dinjitetin njerëzor nuk mund të arrihen me forcë. Ky duhet të jetë një përkushtim afatgjatë i gjitha subjekteve me qëllim të ndërtimit të përbashkët të sigurisë individuale dhe globale.

>>Nuk do të ketë paqe ndërmjet kombeve pa pasur paqe ndërmjet religjioneve. Nuk do të ketë paqe ndërmjet religjioneve pa dialog mes religjioneve. Nuk do të ketë dialog ndërmjet religjioneve, pa e hulumtuar themelimin e religjioneve.<<

2. DEFINIMI DHE PËRSHKRIMI I ÇËSHTJES



Ç' është religjioni?

Në kuadër të debateve filozofike dhe sociologjike, nuk ekzistojnë ndonjë **definicion i përbashkët** për religjionin. Megjithatë, nga definicionet e ndryshme që janë propozuar, ekzistojnë disa elemente të përbashkëta.

Religjioni, i cili etimologjikisht lidhet me fjalën latine *religere* i referohet “lidhmshërisë”. Religjioni është ai që lidh besimearët me diçka “absolute”, të konceptuar, qoftë sipas konditave personale qoftë sipas atyre jopersonale. Zakonisht përfshin një përmbledhje të riteve dhe ritualeve, rregullave dhe rregullimeve, të cilat ua mundësojnë individëve ose bahkësive ta lidhin ekzistencën e tyre me një “Zot” ose disa “Zota”. Sipas Millton J. Jinger (Milton J. Yinger), religjioni mund të jetë “një sistem i besimeve dhe praktikimeve përmes të cilave një grup i njerëzve lufton problemet më të mëdha të jetës.”

Sa për krahasim, Black's Law Dictionary, e definon religjionin si

“Marrëdhënie e njeriut ndaj Hyjnorës, adhurimit, kultit, bindjes dhe nënshtrimit ndaj mandatit dhe porosive të krijesave supernatyrore ose superiore. Në kuptimin e tij më të gjerë, religjioni përfshin të gjitha format e besimit për ekzistimin e krijesave superiore, të cilat ushtrojnë pushtet mbi njerëzit përmes dhunës, imponimit të rregullave të sjelljes dhe shpërblimeve ose dënimeve të ardhshme.”

Ky dhe të gjitha definicionet e tjera, përfshijnë pranimin e ekzistimit të një diçkaje të personalizuar ose jo, që është superiore, e shenjtë, absolute dhe e jashtëzakonshme. “Supremja” ose “e para” ka funksion normativ dhe nga besimtarët pritet t’i respektojnë mësimet dhe rregullat e sjelljes sipas religjionit të tyre, si rrugë drejt këtij “absolutizmi”. Gjithashtu, nga besimtarët pritet t’i shprehin besimet e tyre religjioze të ndryshme përmes adhurimit ose kryerjes së kultit. Në përgjithësi, por jo gjithëherë, janë themeluar kisha ose institucione të tjera, me qëllim të organizimit të grupit ose praktikimit të adhurimit.



Ç' është besimi?

Besimi është **koncept më i gjerë** sesa religjioni. Besimi përfshin religjionin, por nuk kufizohet vetëm në kuptimin e tij tradicional. Black's Law Dictionary, e definojnë atë si “*besim në të vërtetën e një propozimi, që subjektivisht ekziston në mendje dhe është nixtur nga agumenti, bindja ose prova e adresuar ndaj gjykimit.*”

Përkundër këtij koncepti eurocentrik të besimit si një akt i mendimit, besimi nënkupton të **besosh** në supremen, shenjtërinë, absoluten dhe të jashtëzakonshmen. Në dokumentet ndërkombëtare, termi *besim* është adaptuar për t'i përfshirë edhe **të drejtat e personave joreligjiozë**, siç janë ateistët (të cilët nuk i besojnë Perëndisë), agnostikët (të cilët janë të pasigurt për ekzistimin e “Zotit”) dhe racionalistët. Besimet e karaktereve të tjera, qoftë politike, kulturore, shkencore ose ekonomike, nuk përfshihen në kuadër të kësaj mbrojtjeje, por duhet të adresohen ndaras.

 Moduli për Lirinë e Shprehjes dhe Lirinë e Mediave.



Ç' janë liritë religjioze?

Në të drejtën ndërkombëtare, liritë religjioze mbrohen si **liri të mendimit, ndërgjegjes dhe religjionit**. Këto tri liri themelore aplikohen njësoj ndaj bindjeve teistike dhe religjioze, si dhe përfshijnë gjitha besimet me pikëpamje të jashtëzakonshme ndaj universit dhe një kod normativ të sjelles.

Në kuptimin e ngushtë, liria e religjionit dhe e besimit përfshijnë *lirinë e* religjionit dhe besimit dhe *lirinë nga* religjioni dhe besimi, të cilat mund të kuptohen si të drejta për të pranuar ose për të mos pranuar një rregull ose sjellje religjioze.

Liria e mendimit dhe ndërgjegjes është e mbrojtur njësoj sikurse edhe liria e religjionit dhe besimit. Kjo përfshin lirinë e mendimit në të gjitha çështjet dhe bindjet personale, si dhe përkushtimet ndaj religjionit ose besimit, qoftë përmes manifestimit individual ose së bashku me tjerët.

Ashtu siç tregon numri i madh i “të burgosurve të ndërgjegjes” në gjithë botën, liria e ndërgjegjes shkilet mjaft shpesh. Këta të burgosur, në të shumtën e rasteve u takojnë minoriteteve religjioze të një regjioni dhe burgosen për shkak të besimeve të tyre religjioze. Tregimi për Z. Atakov është vetëm një nga shembujt e panumërt. Liria e mendimit dhe ndërgjegjes, si dhe liria për të zgjedhur dhe ndryshuar religjionin ose

besimin, janë të **mbrojtura pa rezervë**. Askush nuk mund të detyrohet t'i zbulojë mendimet e tij ose të saj, e as t'i bashkohet ndonjë religjioni ose besimi.



Standardet ndërkombëtare

E drejta mbi të drejtat e njeriut i shmanget kontraversës së definimit të religjionit dhe besimit, por përmban një **katalog të të drejtave** për të mbrojtur lirinë e mendimit, ndërgjegjes, religjionit dhe besimit. Për të kuptuar më mirë kompleksitetin e lirive religjioze, mund të bëhet një klasifikim i tyre në tri nivele:

1. Liritë e praktikimeve të posaçme individuale
2. Liritë e praktikimeve kolektive
3. Liritë e godinave të caktuara

➤ Liritë e praktikimeve të posaçme individuale:

Neni 18 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (UDHR) identifikon **liritë religjioze si të drejta të “të gjithëve”** (që do të thotë se i mbron fëmijët, të rriturit, vendorët dhe të huajt), të cilat **nuk mund të derogohen, madje as në raste të gjendjes së jashtëzakonshme ose luftës**. Lista e lirive individuale religjioze e parashikuar me Nenin 18 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejta Civile dhe Politke, ofron formulimin e detajizuar të të drejtave që gjenden brenda standardeve minimale të pranuar ndërkombëtarisht:

- Lirinë për të manifestuar individualisht ose së bashku religjioni dhe besimin, si dhe për të themeluar dhe mbajtur vende për këtë qëllim;
- Lirinë për të prodhuar, blerë dhe përdorur deri në një masë të caktuar, artikujt dhe materiale të nevojshme që kanë të bëjnë me ritet ose zakonet e një religjioni dhe besimi;
- Lirinë për të kërkuar dhe pranuar ndihma financiare dhe kontribute të tjera nga individët dhe institucionet e tjera;
- Lirinë për të trajnuar, emëruar, zgjedhur, ose caktuar sipas trashëgimisë udhëheqësit e caktuar, sipas kërkesave dhe standardeve të çfarëdo religjioni ose besimi;
- Lirinë e individëve për të zbatuar ditët e pushimit dhe për të festuar ditët e shenjta dhe ceremonitë, në pajtim me parimet e religjionit dhe besimit të tij/saj;

- Liritë religjioze në punë, duke përfshirë të drejtën për t'u lutur, veshur dhe për të ngrënë sipas parimeve të religjionit dhe besimit të caktuar;
- Lirinë për t'u mbledhur dhe bashkuar për të kryer dhe zbatuar ritet;
- Lirinë për të deklaruar lirshëm besimin;
- Të drejtën për të ndryshuar dhe refuzuar një religjion;
- Të drejtën për arsimim religjioz për “interesa” të fëmijës.

➤ Liritë e Praktikimeve kolektive:

Liritë religjioze nuk u mundësojnë vetëm individëve gëzimin e lirive të përmendura më lartë. Një religjion ose besim mund dhe zakonisht manifestohet në bashkësi me tjerët, që do të thotë se manifestohet në vende publike. Kjo nënkupton respektimin e lirisë së grumbullimit dhe bashkimit, gjithashtu edhe të bashkësive të besimtarëve.

➤ Liritë e godinave të caktuar:

Organet e caktuar që janë të bazuara në parime religjioze, gjithashtu gëzojnë mbrojtje të plotë përmes lirive religjioze. Këto organe mund të jenë shtëpitë e kultit ose institucionet arsimore që merren me çështje religjioze, ose edhe OJQ-të.

Të drejtat e tyre përfshijnë:

- Lirinë për të themeluar dhe mbajtur institucione të caktuara bamirëse ose humanitare;
- Lirinë për të shkruar, publikuar dhe përhapur publikime të rëndësishme të këtyre fushave;
- Lirinë për të ofruar mësim për religjion nëpër vende të përshtatshme.

Parimi i mosdiskriminimit

Diskriminimi dhe jotoleranca mbi baza religjioze që nënkupton çfarëdo dallimi, përjashtimi, kufizimi, ose preferencë të bazuar në religjion ose besim, është i ndaluar. Ndalimi i diskriminimi dhe jotolerancës religjioze nuk vlen vetëm për jetën publike, por gjithashtu ka të bëjë me sferën private të individëve, në të cilën janë të futura thellë besimet dhe religjionet. Kjo do të thotë, se as shteti e as punëdhënësi juaj, ose ndonjë individ tjetër, nuk lejohet të ndërmarrë ndonjë veprim diskriminues ndaj jush.



Moduli për mosdiskriminim

Edukimi

Prindërit kanë të drejtë të vendosin se në çfarë religjioni dëshirojnë t'i edukojnë fëmijët e tyre. Dsipozita “në interesin më të mirë të fëmijës”, ka për qëllim kufizimin e lirisë së veprimit të prindërve, vetëm atëherë kur një praktikë fetare mund ta dëmtojë shëndetin fizik ose mental të fëmijës. Si praktikë e tillë mund të jetë refuzimi i prindit për trajtim mjekësor dhe arsimim shkollor të fëmijës. Për shembull, refuzimi i transfuzionit të gjakut mund të shkaktojë vdekjen e fëmijëve te Dëshmitarët e Jehovait (Jehovah's Witnesses), besimi i të cilëve është në kundërshtim me trajtimet mjekësore.

Në sferën publike, shtetet kanë obligim të ofrojnë arsimimin, i cili mbron fëmijën nga jotoleranca dhe diskriminimi religjioz dhe të ofrojë planprograme, të cilat përfshijnë edhe mësimin e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe religjionit.



PYETJET PËR DISKUTIM

- Si rregullohet përdorimi i religjionit në vendin tuaj?
- Planprogrami shkollor dhe librat shkollore në vendin tuaj, a trajtojnë lirinë e religjionit dhe besimit, si dhe përfshin edhe lirinë për të mos besuar?
- A ka masa siguroese në vendin tuaj, për të siguruar pavarësinë e përdorimit të religjionit?

Manifestimi i besimit

Liria për të manifestuar besimin religjioz përfshin mbrojtjen e fjalëve, mësimëve, praktikimeve, kulteve dhe zbatimit të atij besimi. Sipas kësaj ke të drejtë të flasësh për fenë tënde, ta mësosh atë, ta praktikosh vetë ose së bashku me tjerët dhe t'i zbatosh rregullat lidhur me ushqimin, veshjen ose përdorimin e një gjuhe të caktuar, si dhe ritualet e lidhura me besimin e caktuar. Manifestimi i religjionit ose besimit nënkupton gjithashtu mundësinë e shmangies së veprimeve të kundërta me rregullat e besimit konkret. Veprimet e tilla mund të jenë refuzimi i dhënies së betimeve, shërbimet ushtarake, pjesëmarrja në ceremoni fetare, pranimet ose trajtimet e detyrueshme mjekësore.

Kufizimet e lirive religjioze

Deri sa nuk është e rëndësishme në çka besohet, manifestimi i besimit mund t'i arrijë limitet, kur me anë të tij preken interesat e të tjerëve. Kufizimet e të drejtës së manifestimit të besimit religjioz duhet të jenë proporcionale dhe të bazuara në ligj. Kufizimet mund të vihen vetëm kur kjo është e domosdoshme për sigurinë dhe rendin publik, shëndetin, moralin ose të drejtat dhe liritë fundamentale të të tjerëve. Kufizimet e këtyre lirive lejohen për shembull te rastet e sakrificave njerëzore, vetëvrasjeve, gjymtimit gjenital të femrave, skllavërisë, prostitucionit, veprimeve shkatërruese dhe praktikave të tjera që kërcënojnë shëndetin njerëzor dhe integritetin fizik.

3. PERSPEKTIVAT NDËRKULTURORE/ ÇËSHTJET KONTRAVERSE



Shteti dhe feja

Ndër dallimet më të mëdha lidhur me mbrojtjen e lirive fetare në botë, kanë të bëjnë me **marrëdhëniet ndërmjet shteteve dhe religjioneve ose besimeve**. Kemi disa modele kryesore të raportit të shtetit dhe fesë: shtete religjioze, kisha të themeluara, neutralitet shtetëror ndaj feve dhe institucioneve të tjera, mosekzistim të ndonjë religjioni zyrtar, ndarje mes shtetit dhe kishës dhe mbrojtje e grupeve religjioze të pranuar me ligj.

Standardet ndërkombëtare nuk kërkojnë ndarjen e shtetit nga kisha ose religjioni. Kjo nënkupton se nuk caktohet ndonjë model konkret i raportit mes shtetit dhe ndonjë besimi, dhe në veçanti nuk kërkohet krijimi i shoqërive laike, të cilat e përjashtojnë religjionin nga çështjet publike. Kërkesa e vetme ndërkombëtare është që një marrëdhënie e tillë nuk duhet të rezultojë në diskriminim ndaj atyre që nuk i takojnë besimit të pranuar zyrtar, ose feve të pranuar me ligj. Mirëpo, atje ku vetëm *një* religjion pranohet si pjesë përbërëse e identitetit kombëtar, është pikëpyetje nëse mund të sigurohet trajtim i barabartë i feve tjera ose feve më të vogla.

Sipas pikëpamjeve perëndimore, një marrëdhënie neutrale mes religjionit dhe shtetit e bën më shumë të mundshëm garantimin e mbrojtjes së plotë të lirive religjioze të individëve. Për shembull, e drejta tradicionale islame ose *E drejta e Sheriati* si kontrast i kësaj pikëpamjeje i lidh shtetin dhe fenë, sepse konsideron se një sistem i tillë mundëson mbrojtje më të mirë të lirive religjioze për popullin. Sido që të jetë, mund të thuhet se kur në shtet është i lidhur me një kishë ose religjion të caktuar, është e pamundshme që të drejtat e anëtarëve të minoriteteve religjioze të kenë mbrojtje të barabartë.



PYETJET PËR DISKUTIM

- Cili është qëndrimi i vendit tuaj ndaj besimeve?
- A i pranon vendi juaj institucionet e feve të ndryshme?
- A mendoni se është e mundur të vendoset sistemi i barabartë ndaj të gjitha feve deri sa privilegjohet njëra?
- A konsideroni se është legjitime të lejohen parti politike religjioze?

Apostatizmi – liria për të zgjedhur ose ndryshuar fenë

Përkundër ekzistimit të rregullave të qarta ndërkombëtare, akti i apostasisë, ose braktisjes së një religjionit për shkak të religjionit tjetër, ose për të jetuar si laik, vazhdon të mbetet një çështje kontraverse.

Një person është apostat, nëse ai ose ajo braktis një religjion dhe merr një religjion tjetër ose vazhdon të jetoj si laik. Historikisht, islamizmi, krishterimi dhe religjionet e tjera kanë marrë qëndrim shumë të errët ndaj apostatëve. Shpesh, dënimi për ata ka qenë ekzekutimi. Sot, në islamizëm, pra në ato shtete që janë të bazuara në Të drejtën e Sheriatit, apostatizmi vazhdon të dënohet shumë rëndë. Në praktikë, kjo shpesh lë të kuptohet se në këto raste nuk ekziston e drejta për të zgjedhur ose ndryshuar religjionin e caktuar.

E drejta ndërkombëtare në mënyrë shumë të qartë e kundërshton këtë pikëpamje. Çdo person ka të drejtë ta zgjedhë besimin e tij, lirshëm dhe pa kurrfarë shtrëngimi. Debati për këtë çështje është shumë emocional dhe i ndieshëm, sepse prek thellë bindjet dhe kuptimet e ndryshme për liritë religjioze. Ky debat, duke i ndarë “perëndimorët” nga të “tjerët”, tregon dallimet kulturore në perceptimin ndaj religjioneve dhe lirive të tjera.



PYETJET PËR DISKUTIM

A mendoni se në praktikë, njerëzit mund ta zgjedhin lirshëm besimin e tyre ose ta ndërrojnë atë? A mund të shkaktojë kjo ndeshje me të drejtat e tjera të njeriut?

Proselitizmi – e drejta për të përhapur besimin

Përderisa nuk përdoret shtrëngimi dhe forca, njeriu ka të drejtë ta përhapë besimin e tij dhe t'i inkurajojë njerëzit që të konvertohen nga njëra fe në tjetrën. Ky veprim njihet si proselitizëm ose evangjelizëm.

Gjatë promovimit të programeve misionare të religjioneve të huaja në Evropë Qendrore dhe Lindore dhe në Afrikë, kanë lindur konflikte mes kishave lokale dhe atyre religjioneve. Madje në disa raste, qeveritë kanë ndaluar aktivitetet e tilla. Të drejtat e njeriut kërkojnë nga qeveritë të mbrojnë të drejtën e të shprehurit dhe që besimtarëve t'u garantohet liria për t'u kyçur në forma jo të dhunshme të proselitizmit, siç janë “zgjimi i thjeshtë i ndërgjegjes” ose ekspozimi i posterëve dhe pllakateve.

Nëse dikush detyrohet që me forcë të konvertohet nga njëra fe në tjetrën, kjo është shkelje e qartë e të drejtave të njeriut, por nëse shtrohet pyetja se çka është e lejuar, kjo ende nuk është rregulluar me të drejtën ndërkombëtare. Në mënyrë që të kufizohet proselitizmi, duhet të paraqitet një “rrethanë e shtrëngimit” siç mund të jetë: përdorimi i parave, dhuratave ose privilegjeve për ata që konvertohen; ose kur proselitizmi bëhet në vende ku njerëzit ndodhen sipas detyrës ose kur kjo u kërkohet me ligj (në shkolla, ndërtesa ushtarake, burgje dhe institucione të ngjashme).

Kundërshtimi i ndërgjegjshëm i shërbimit ushtarak

Kontraversa ndërkulturore mbi të ashtuquajturin kundërshtim i ndërgjegjshëm i shërbimit të detyrueshëm ushtarak, ende vazhdon. Një person mund të përjashtohet nga shërbimi ushtarak, nëse detyrimi për të përdorur armë të ftohta ndeshet në mënyrë serioze me ndërgjegjen e atij personi; dhe nëse ndaj personave të besimit tjetër nuk rezultohet në ndonjë dallimi të kundërt.

Ky trend i njohjes së kësaj të drejte nga ana e ligjeve kombëtare vërehet në disa shtete në të cilat ofrohen shërbimet shoqërore si alternativë (Austri, Francë, Kanada ose SHBA). Në anën tjetër, në shtetet e tjera ku nuk ekziston kundërshtimi i ndërgjegjshëm i shërbimit të detyrueshëm ushtarak, njerëzit mund të burgosen për refuzim e mbajtjes së armëve.



PYETJET PËR DISKUTIM

- A ka në vendin tuaj të burgosur të ndërgjegjes?
- A mendoni se ekziston nevoja për të drejtën e *refuzimit* për të vrarë, e cila duhet të njihet shprehimisht me standarde ndërkombëtare?

4. ZBATIMI DHE MONITORIMI

Problemi kryesor për implementimin e të drejtave religjioze, është thjesht mungesa e një instrumenti të obligueshëm ndërkombëtar. *Deklarata e OKB-së për Eliminimin e të Gjitha Formave të Jotolerancës dhe Diskriminimit të bazuar në Religjion dhe Besim* e vitit 1981, ka një efekt të konsiderueshëm juridik, sepse mund të konsiderohet si rregull i vendosur i të drejtës ndërkombëtare zakonore. Por, deklarata nuk është marrëveshje, prandaj edhe nuk krijon obligime ligjore. Me gjithë një pajtim ndërkombëtar për nevojën e ekzisimit të një konvente, ende nuk është arritur një pajtim se në çka duhet përqendrohet më shumë fokusi.

Me qëllim të implementimit dhe monitorimit të Deklaratës së vitit 1981, është themeluar **Raportuesi Special për Jotolerancë Religjioze** në vitin 1986. Kryesisht, mandati i tij është identifikimi i incidenteve dhe veprimeve të qeverisë të cilat janë në kundërshtim me dispozitat e Deklaratës, si dhe t'u bëjë shteteve rekomandime për mjetet dhe masat që duhet t'i ndërmarrin. Është vërtetuar se persekutimi dhe diskriminimi religjioz ka prekur individë dhe komunitete në mbarë botën dhe të të gjitha feve. Persekutimi dhe diskriminimi religjioz paraqitet duke filluar nga përmasat e vogla si persekutimi dhe diskriminimi religjioz, shkeljet e parimit të mosdiskriminimit dhe tolerancës në religjion dhe besim, e deri te atakimi i së drejtës për jetë, integritetit fizik dhe sigurisë njerëzore të personit.

Gjithashtu, edhe instrumente regjionale merren me implementimin e lirisë së religjionit: për shembull Komisioni Afrikan për të Drejtat e Njeriut në rastet e fundit në Sudan ka vendosur që aplikimi i të **drejtës së Sheriatit** duhet të bëhet në pajtim me obligimet ndërkombëtare.

Masat parandaluese dhe strategjitë e ardhshme

Para se të vazhdohet të punohet në drejtim të një konvente të obligueshme ligjore, me qëllim të zhvillimit të një *kulture të bashkjetesës multireligjioze*, duhet të promovohet më mirë *Deklarata e OKB-së për Eliminimin e të Gjitha Formave të Jotolerancës dhe Diskriminimit të bazuar në Religjion dhe Besim* e vitit 1981. Vëmendje e posaçme duhet të vendoset te roli i arsimimit, si metodë kryesore e luftimit të jotolerancës dhe diskriminimit religjioz. Sipas të së drejtës ndërkombëtare, shtetet kanë obligim të qartë

për t'iu kundërpërgjigjur dhunës dhe diskriminimit në çështjet e besimit. Është e qartë se, me qëllim të mbrojtjes së të persekutuarve dhe promovimit të tolerancës, OJQ-të, organizatat religjioze dhe ato laike, përmes fushatave informative, ngritjes së vetëdijes, programeve arsimuese dhe mësimi, gjithashtu kanë rol të barabartë për ndriçimin e shkeljeve nga shteti dhe të tjerët.

Çka mund të bëjmë ne?

Ne mund të parandalojmë diskriminimin dhe persekutimin religjioz, duke filluar t'i respektojmë të drejtat e të tjerëve. Toleranca religjioze e ndërlidhur me fenë, përfshin **respektimin e besimtarëve të feve të tjera, pa marrë parasysh se a mendojmë ne që feja e tyre është e vërtetë apo jo.** Ky respekt dhe kjo kulturë e tolerancës **kërkon nga ne që të refuzojmë të diskriminojmë, denigrojmë dhe nënvlerësojmë religjionet e të tjerëve, si dhe ta respektojmë të drejtën fundamentale për të qenë i ndryshëm.** Kjo gjithashtu nënkupton refuzimin për të diskriminuar kundër të tjerëve në punësim, strehim dhe qasje ndaj shërbimeve publike, për shkak të besimit tjetër. Për më tepër, neve na duhet respekti për të filluar të ndryshojmë sjelljen. Ekziston nevoja për dialog ndërfetar, si dhe për takim mes besimtarëve dhe jobesimtarëve në një vend të përbashkët, për t'u mësuar të shprehin respekt ndaj njëri-tjetrit.

E DOBISHME TË DIHET

1. PRAKTIKA TË MIRA



Dialogu ndërfetar për pluralizëm religjioz

Gjatë disa dekadave të fundit, pyetjet e pluralizmit religjioz dhe kulturor kanë ringjallur përsëri interesimin e bashkësive kishtare dhe interesimin e besimtarëve. Ekziston një ndjenjë e sensit të menjëhershëm për ndërtimin e marrëdhënieve pozitive mes popujve të besimeve të ndryshme. Me rritjen e interesit për dialog është rritur, gjithashtu, edhe aktualiteti i tij, duke ua mundësuar kështu bashkësive të ndryshme religjioze që ta kuptojnë më mirë njëra-tjetrën dhe të punojnë më shumë së bashku për edukimin dhe zgjidhjen e konflikteve, si dhe në përditshmërinë e jetës së komuniteteve të tyre. Ndër

OJQ-të ndërkombëtare të shumta që punojnë në promovimin e dialogut religjioz dhe paqes, janë:

- Këshilli Botëror i Kishave;
- Konferenca Botërore mbi Religjionin dhe Paqen (WCPR) me grupet punuese të përhershme për “religjionin dhe të drejtat e njeriut”;
- Parlamenti Botëror i Religjioneve;
- Fondacioni i Etikës Globale;
- Bashkësia Botërore e Këshillave Ndërreligjioze (WFIRC).

Krahas këtyre, një numër i madh i **iniciativave lokale dhe regjionale**, përmes dialogut në mbarë botën, janë duke ndihmuar zgjidhjen e konflikteve dhe parandalimin e konflikteve në botë:

- Në Lindjen e Mesme, *klerikët për paqe* mbledhin rabinët, priftërinjtë, pastorët dhe imamët e Izraelit dhe Bregut Perëndimor (West Bank), që të ndërmarin veprime të përbashkëta dhe të jenë dëshmitarë të paqes dhe drejtësisë në rajon;
- Në Indinë Jugore, *këshilli i hirësisë* mbledh së bashku hindut, të krishterët, myslimanët, budistët, jainsit, zoroastrianët, hebrenjtë dhe siksët, në përpjekje që të adresohen rastet e konflikteve të bashkësive;
- Në Pacifik, *hulumtimi ndërfaqësor* mbledh së bashku përfaqësuesit e shumë religjioneve në Fixhi, duke bërë përpjekje për të tejkaluar paragjykimet dhe për të promovuar respektin e ndërsjellë dhe vlerësimin për njëri-tjetrin.
- Në Evropë, “Projekti: Evropa ndërfaqësore” është i pari i llojit të tillë, që fton politikanët urbanë dhe përfaqësuesit e religjioneve të ndryshme nga e gjithë Evropa në qytetet e Gracit dhe Sarajevës.



PYETJET PËR DISKUTIM

“Në dialog, bindja dhe çiltërsia mbahen të balancuara.” Si mund të bëhet kjo, individualisht dhe në bashkësi?



“Religjionet për paqe” përmes arsimimit

Arsimimi ndërreligjioz inkurajon respektimin për njerëzit e feve të tjera dhe përgatit studentët për t'i lënë anash barrierat e paragjyqimeve dhe jotolerancës.

- Në Izrael, projekti i quajtur “Vlerat e përbashkëta/ Burimet e ndryshme” mbledh në një vend hebrenjtë, myslimanët dhe të krishterët, për t'i studiuar së bashku tekstet e shenjta, në kërkim të vlerave të përbashkëta, që do të mund t'i zbatonin në jetën e tyre të përditshme dhe eventualisht të dilnin me një libër për përdorim shkollor;
- Në Tajlandë dhe Japoni, kohët e fundit, Kampet Etike të Rinjëve Liderë, mbledhën në një vend përfaqësuesit e rinj të bashkësive religjioze të këtyre shteteve për programe trajnuese në pikëpamje të lidhshme, etikës morale, shërbimeve shoqërore dhe forcimin e pajtimit.
- Në Gjermani, Angli dhe në shtete të tjera, mësuesit janë duke analizuar trajtimin e traditave religjioze në librat shkollorë, tradita të cilat janë të panjohura për audiencën, së cilës i janë kushtuar këto libra.

2. TRENDET

Kultet, sektet dhe lëvizjet e reja religjioze

Dhjetëra ndërtesa dëmtohen si rezultat i sulmit të turmës së indonezianëve ndaj sektit islamik: XHAKARTA, 24 dhjetor: Policia njoftoi sot se, në provincën indoneziane të Javës perëndimore, turmat kanë dëmtuar dhe demoluar afër njëzet shtëpi dhe dy xhami të lidhura me sektin Ahmadiyah Islamik. Jana tha se hetimet janë duke vazhduar, por ende nuk është bërë ndonjë arrestim.

(AFP) (Vendosur në ora 10:00 PST)

BURIMI: [HTTP://WWW.DAWN.COM/2002/12/24/WELCOME.HTM](http://www.dawn.com/2002/12/24/welcome.htm), JANAR 2003

Liria e religjionit nuk duhet të interpretohet ngushtë në atë mënyrë që do të nënkuptonte vetëm religjionet tradicionale të botës. Religjionet e reja dhe religjionet e vogla kanë gjithashtu të drejtë për mbrojtje të barabartë. Ky parim është i rëndësishëm së veçantë në dritën e ngjarjeve të fundit, ku lëvizjet e religjioneve të reja janë bërë shënjestra të herpasheshme të diskriminimit dhe represionit. Këto lëvizje të reja njihen me disa emra të ndryshëm dhe kanë nevojë për studim më të afërt. Termet “kult” ose “sekt” përdoren për t'iu referuar grupeve të ndryshme religjioze, të cilat në besim dhe praktika të tyre

dallojnë prej religjioneve kryesore. Të dyja këto shprehje janë të paqarta, por në përgjithësi sekti i referohet një grupi të ndarë nga një religjion, pra si një degë e ndarë e një religjioni madhor, derisa kultet në përgjithësi njihen si sisteme ortodokse ose të kopjuara të besimeve religjioze, që shpesh përcillen me rituale të njëjta. Pasi që të dyja këto terme janë definuar duke “u ndarë nga baza”, pikëpamjet lidhur me atë se çka e përbën një sektë ose një kult, dallojnë te besimet e ndryshme. Budizmi dhe hinduizmi do ta përdornin këtë në formë shumë neutrale, deri sa në botën perendimore “sekti” ose “kulti” shpesh përdoren në kontekst negativ. Këto lëvizje nuk dalin gjithëherë vetëm nga dallimet e këtyre grupeve në krahasim me bazën, por gjithashtu sepse janë të lidhura shpesh nga dedikimi i plotë dhe keqpërdorimi i bazuar financiar. Një shembull i famshëm dhe kontravers është Kisha e Shkencës, së cilës në disa shtete, ndër to në Gjermani si shembulli më i mirë, nuk i është dhënë liria religjioze, sepse konsiderohet të jetë kompani.



PYETJET PËR DISKUTIM?

- A mbrohen besimet e vogla në vendin tuaj dhe nëse po, si?
- A kanë ato të drejta dhe përkrahje të barabartë si besimi(et) kryesore?

Gratë dhe feja

Përgjatë historisë gratë janë diskriminuar pothuaj nga të gjitha fetë. Dhe, vetëm tani vonë janë adresuar liritë e tyre religjioze. Diskriminimi i grave në religjione është i dyfishtë. Atyre u mungon liria e manifestimit të fesë së tyre, pasi që nuk kanë qasje të barabartë në vendet e lutjes, nuk predikojnë dhe nuk udhëheqin. Po ashtu, ato mund të bëhen viktime të feve të caktuara, sa herë që rregullat fetare, praktikat dhe zakonet i dënojnë ato, ose edhe e kërcënojnë jetën e tyre:

- Përqindja e vajzave të reja të gjymtuara në vendet rurale të Egjiptit është 95%. Gjymtimi gjenital i femrave është traditë religjioze dhe kulturore në shumë shtete dhe kundërshtohet fuqishëm me standarde ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Si pasojë e kësaj, mund të shkaktohen probleme të rënda shëndetësore, të cilat mund të rezultojnë në vdekje.

- Martesat e dhunshme të cilat shpesh rezultojnë në skllavëri, zbatohen sidomos në disa pjesë të Nigerisë, Sudanit, Pakistanit dhe rajone të tjera. Në këto raste, nuk është i nevojshëm pajtimi i gruas për martesë. Nganjëherë ndodh që “gratë” të jenë më të vjetra se nëntë vjeç.
- Dhuna si formë specifike e “spastrimit etnik”: në shumë raste përkatësia fetare e viktimave ka qenë motiv për dhunime masive në ish-Jugosllavi, Gjeorgji, Sudan, Ruandë ose Çeçeni. Shtatëzanësitë e imponuara të grave të dhunuara, kanë bërë që ato të njollosen publikisht si të dhunuara dhe në këtë mënyrë përveçse janë dëmtuar fizikisht, ato edhe janë turpëruar dhe çnderuar.

Ekstremizmi religjioz dhe ndikimi i tij

Pas sulmeve të 11 shtatorit të vitit 2001, po duket se terrorizmi ka instrumentalizuar besimin religjioz më shumë se kurdoherë. Shumë njerëz konkludojnë se kjo ngjarje tragjike vetëm se ka shënuar kulmin e lidhjes mes terrorizmit dhe fesë: rrëmbimi i aeroplanëve, bombardimi i ambasadave perëndimore në shtetet dominuese myslimane, pastaj “çështja e palestinezëve” dhe konfliktet e tjera në botë të “intensitetit më të ulët”, kanë theksuar religjionin për arsye të politike.

Sido që të jetë, një ndërlidhje e tillë është shumë e rrezikshme. Një gjë e tillë e ndan botën, në të “mirët” dhe të “këqinjët” dhe kështu i njollos njerëzit në bazë të përkatësisë së tyre fetare. Por, jo të gjithë terroristët ose ekstremistët janë religjiozë, ashtu siç nuk do të jenë të gjithë besimtarët terroristë. Në ato raste kur sulmet ekstremiste lidhen me fenë, pra kur kryesisht theksojnë se e kanë kryer krimin “në emër të Zotit”, religjioni dhe liritë e tij përdoren dhe keqpërdoren për t’i mbuluar veprimet ose kërkesat e motivuara politike.

Duke pasur parasysh se ekstremizmi paraqet një kërcënim global dhe jo të kufizuar vetëm ndaj një shoqërie ose feje të caktuar, por një goditje të bazuar në injorancë dhe jotolerancë, përdorimi i terrorizmit në emër të fesë nuk paraqet ndeshje mes kulturave të ndryshme të bazura në besime religjioze.



PYETJET PËR DISKUTIM

- Cilat janë arsyet kryesore për konflikte brenda dhe në mes bashkësive religjioze. A mund të japësh ndonjë shembull nga përvoja personale?

- Çka mendoni, cili është roli i feve në kërkim të paqes dhe zgjidhjes së konflikteve?
Mendo për ndonjë shembull ku religjioni ka shërbyer si agjent për pajim!

3. KRONOLOGJIA

Hapat kryesor të zhvillimit historik të lirive religjioze

1776 Ligji mbi të Drejtat i Virgjinisë, Amandamenti i parë

1948 Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (Nenet 2 dhe 18)

1948 Konventa për Parandalimin dhe Dënimin e Krimeve të Gjenocidit (Neni 2)

1950 Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Fundamentale të Njeriut (Neni 9)

1966 Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (Nenet 18, 20, 24, 26f)

1969 Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut (Nenet 12, 13, 16f, 23)

1981 Deklarata e OKB-së për Eliminimin e të Gjitha Formave të Jotolerancës dhe Diskriminimit të bazuar në Religjion ose Besim

1981 Karta Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe Popujve (Nenet 2, 6, 12)

1990 Deklarata e Kairos për të Drejtat e Njeriut në Islam (Neni 10)

1992 Deklarata e OKB-së për të Drejtat e Personave të Minoriteteve Etnike, Religjioze dhe Gjuhësore (Neni 2)

1998 Karta Aziatike për të Drejtat e Njeriut (Neni 6)

AKTIVITETE TË PËRZGJEDHURA



AKTIVITETI 1:

FJALËT QË PLAGOSIN

PJESA I: HYRJE

Ky aktivitet ka për qëllim t'i tregojë kufijtë e lirisë së shprehjes, pra kur ajo çka ne bëjmë ose flasim ndeshet me besimet religjioze dhe ndjenjat e të tjerëve.

Forma e aktivitetit: diskutim

PJESA II: INFORMATA TË PËRGJITHSME PËR USHTRIMIN

Qëllimet dhe Synimet

- Të zbulohen dhe të pranohen ndenjat religjioze të njerëzve të tjerë
- Të mësohen përkufizimet e lirisë së shprehjes

Grupi i synuar: të rriturit e rinj dhe të rriturit

Madhësia e grupit/organizimi shoqëror: 8 – 25

Kohëzgjatja: së paku një orë

Materiali: tabelë dhe marker

Përgatitja:

Duhet të përgatitet tabela dhe markerët

Aftësitë e përfshira:

Dëgjimi i të tjerëve, ndieshmëria dhe pranimi i të tjerëve

PJESA III: INFORMATA SPECIFIKE PËR USHTRIMIN

Përshkrimi i aktivitetit/ Instruksionet

- Kërko nga pjesëmarrësit të japin ide të shpejta për të krijuar një listë të komenteve ose deklaratave lënduese dhe stereotipeve që kanë të bëjnë me ndërgjegjen ose besimin religjioz të dikujt; ndaj atyre që pjesëmarrësit e dijnë se do të shkaktojnë shqetësim. Zgjidh disa nga deklaratat më të këqija dhe shënoji ato në tabelë.
- Ndaj pjesëmarrësit në grupe prej 4 deri në gjashtë persona. Njëri nga secili grup duhet ta lexojë deklaratën e parë. Grupi thjesht duhet të pranojë se komenti i tillë e ka lënduar dikë. Mirëpo, nuk do të pyeten nëse ata mendojnë se deklarata ishte lënduese ose jo.
- Nxiti pjesëmarrësit për të biseduar pse personat e lënduar mund të ndihen ashtu si ndihen; a u duhet lejuar njerëzve të flasin gjëra të tilla, pa marrë parasysh efektin e atyre fjalëve; dhe çka duhet bërë në rastet kur kjo ndodh.
- Përsërite këtë për secilën deklaratë.

VLERËSIMI

Diskutimi

- Si ndihen pjesëmarrësit pas aktivitetit? A ishte vështirë të pranoheshin komentet që lënduan të tjerët dhe të rrish i qetë?

- Çfarë kufizimesh duhet të vendosen për atë se çka mund të flasim për mendimet dhe besimet tona? A duhet të kemi mundësi të themi gjithmonë atë që dëshirojmë?

Këshilla metodlogjike

Gjatë këtij aktiviteti, mundohu të jesh diskret, duke mos i peshuar deklaratat.

Sygjerime për ndryshim

Si përmbyllje e aktivitetit: një letër të gjithëve. Shkruaj emrat e të gjithë pjesëmarrësve në një letër të vogël, kërko nga secili të vizatojë diçka dhe t'i shkruajë gjëra të këndshme atij personi, një përfundim i përshtatshëm për shumë aktivitete që nxisin kontraversa dhe emocione.

PJESA IV: VAZHDMI

Nëse pjesëmarrësit vazhdojnë të punojnë bashkërisht, do të ishte aktivitet i përshtatshëm nëse i lejohet grupit të përcaktojë dhe të vendosë rregullat e diskutimit ose komunikimit të cilat do të ngjiteshin në mur, në mënyrë që të gjithë ta kenë rastin t'iu referohen atyre, kurdo që ata mendojnë se kjo është e nevojshme.

Të drejtat e ngjashme: liria e të shprehurit



2

AKTIVITETI II: FEJA IME DHE FEJA E FQINJIT TIM

PJESA I: HYRJE

Objekt i këtij aktiviteti është parimi i mosdiskriminimit dhe ndalimi i jotolerancës së bazuar në religjion. Më së miri është të punohet me grupe të besimeve të ndryshme religjioze.

Forma e aktivitetit: aktivitet i shumanshëm

PJESA II: INFORMATA TË PËRGJITHSHME PËR USHTRIMIN

Qëllimet dhe Synimet

- Të përpunohet dhe kuptohet nocioni i tolerancës
- Të analizohen faqet e lirive religjioze
- Të zhvillohen imagjinata dhe aftësitë për mendim kreativ
- Të mësohet për zakone dhe kultura të ndryshme

Grupi i synaur: të rriturit e rinj dhe të rriturit. Me një modifikim të vogël, ky aktivitet mund të përdoret me nxënës të të gjitha moshave.

Madhësia e grupit/organizimi shoqëror: 5 – 30

Kohëzgjatja: 2-4 orë

Përgatitja:

Duhet të përgatiten tabela, letra për tabelë dhe markerë për të shkruar

Aftësitë e përfshira: aftësi sociale: dëgjim i analizave të të tjerëve, komunikim; aftësi për mendim kritik; shfaqje e mendimit të tjerëve, mendim reflektiv; aftësi kreative: krijim i metaforave dhe simboleve ilustruese.

PJESA III: INFORMATA SPECIFIKE PËR USHTRIMIN

Përshkrimi i aktivitetit/ Instruksionet

Pjesa e parë

- Aktivitet grupor: krijo një tabelë me dy kolona. Emërto njëren kolonë “Tolerancë” dhe tjetrën “Jotolerancë”. Kërko nga pjesëmarrësit të japin shembuj të shpejtë për t’i shkruar nën secilën kolonë.
- Pastaj kërko nga ata t’i shqyrtojnë dhe krahasojnë të dy kolonat. (këshillë: ajo që ndodh më së shpeshti është se të gjitha definicionet dhe shembujt nën `Tolernacë` janë më parë `pasive` sesa `aktive`. Nëse ndodh kështu, atëherë potencojë këtë fakt.)
- Raportimi i përvojave personale të jotolerancës: kërko nga pjesëmarrësit të përshkruajnë një incident të jotolerancës që ata e kanë përjetuar. Si do të ishte dashur të trajtohej ose shmangej ai? A mendojnë pjesëmarrësit se ekzistojnë mënyra për të edukuar njerëzit për sjellje tolerante?

Vlerësimi

Nocioni i tolerancë: duke i krahasuar të dy kolonat, çka mund të vërejnë pjesëmarrësit? Çka do të duhej të përfshinte një definicioni i përgjithshëm i tolerancës ose jotolerancës? Pyeti për këtë pjesëmarrësit dhe vështro pikëpamjen e tyre të përbashkët. Pastaj jepjua pjesën e parë të definicionit nga *Deklarata e OKB-së mbi Parimet e Torturës*:

“[toleranca] është një qëndrim aktiv dhe përgjegjësi që përkrah të drejtat e njeriut, pluralizmin (duke përfshirë pluralizmin kulturor), demokracinë dhe sundimin e ligjit.”

Pjesa e dytë

- Organizo një takim multikulturor. Kërko nga secili pjesëmarrës të prezantojë një anëtar të një grupi tjetër religjioz.
- Kërko nga ata të ilustrojnë me anë të pikturimit, pantomimës, këngës, vizatimit ose aktrimit, diçka që do të shfaqte zakonet dhe besimet e rajoneve të tyre.
- Lejo pjesëmarrësit të përgatiten për 20 minuta.
- Kërko nga ata të bëjnë një *prezantim* për zakonet e ndryshme që kanë të bëjnë me secilin religjion që ata përfaqësojnë.

Vlerësimi

- Çka mund të mësojnë pjesëmarrësit nga aktiviteti? A kanë prezantimet e ndryshme diçka të përbashkët?
- A është më lehtë për pjesëmarrësit që t’i tolerojnë besimet/religjionet e tjera pasi që kanë pasur rast të mësojnë diçka për to?
- Shpërndaje pjesën e dytë të *Deklaratës së OKB-së mbi Parimet e Torturës*: [Toleranca] i obligon shtetet anëtare të “t’i edukojnë qytetarët që të jenë të kujdesshëm dhe përgjegjës ndaj kulturave të tjera, të jenë në gjendje t’i çmojnë vlerat e lirisë, ta respektojnë dinjitetin dhe dallimet njerëzore, dhe të jenë të aftë t’i parandalojnë konfliktet ose t’i zgjidhin ato përmes mjeteve jo të dhunshme.

Këshilla metodologjike

Për pjesën e dytë të ushtrimit, kujdesu që grupi t’i respektojë besimet e pjesëmarrësve të tjerë. Për këtë arsye, ky aktivitet nuk duhet të përdoret si “aktivitet për t’u njohuar”. Gjithashtu, sigurohu që prezentimi i zakoneve të ndryshme nuk do t’i lëndojë ndjenjat e besimtarëve të tjerë dhe nuk do t’i diskriminojë ata. Ky ushtrim prezantohet te pjesëmarrësit si përpjekje për t’i paraqitur lutjet ose ritet e caktuara, e jo për të treguar pse ata janë të “mirët” ose të vetmit “të vërtetë”. Para se të fillohet, është mirë që të gjithë pjesëmarrësit të pajtohen për një shenjë (p.sh. një copë letër e kuqe), që do të ndalojë

prezentimin, i cili mund të jetë ofendues, ose thjesht i bazuar në keqkuptime ose informata të gabuara.

Nëse me gjithë instruksionet tuaja pjesëmarrësit vazhdojnë të jenë të diskriminuar, ndërprite prezantimin dhe bisedo për motivet e keqkuptimit të të dyja palët.

Sygerime për ndryshim

Nëse punoni me fëmijë mund t'i përdorni dy pjesët e aktivitetit, duke i lënë anash definicionet e përcaktuara në Deklaratën e OKB-së mbi Parimet e Torturës. Nëse punoni në shkollë, për pjesën e dytë të ushtrimit mund të bashkëpunoni me mësuesin e artit. Prezantimi mund të bëhet gjithashtu me plastelin dhe materiale të tjera.

PJESA IV: VAZHDIMI

Pas këtij aktiviteti të bazuar në përvojë dhe kreativitet, mund të vazhdoni me disa informacione intelektuale, si p.sh. me materiale mbi tolerancën dhe jotolerancën.

Të drejtat e ngjashme/ fushat e tjera të hulumtit

Diskriminimi mbi baza tjera, si raca, ngjyra, gjinia ose përkatësia etnike.

BURIMI: MARRË NGA CHYBERSCHOOLBUS, AVAILABLE AT:

[HTTP://WWW.UN.ORG/CYBERSCHOOLBUS/HUMANRIGHTS/DECLARATION/18.ASP](http://www.un.org/cyberschoolbus/humanrights/declaration/18.asp), DECEMBER 2002

BIBLIOGRAFIA

Amor, Abdelfattah. Report of the Special Rapporteur on Religious Intolerance, U.N. ESCOR 54th Sess., Agenda Item 18, U.N. Doc. E/CN.4/1998/6.

<http://www.hri.ca/fortherecord1998/documentation/commission/e-cn4-1998-6.htm>

Black's Law Dictionary, 6th ed. 1990. West Group.

Boyle, Kevin and Juliet Sheen. 1997. *Freedom of Religion and Belief – A World Report.* Pointing- Green Publishing Services, London and New York.

Evans, Malcolm D. and Rachel Murray, eds. 2002. *The African Charter on Human Rights and People's Rights. The System in Practice, 1986-2000.* Cambridge University Press.

Krishnaswami, Arcot. *Study of Discrimination in the Matter of Religious Rights and Practices,* U.N. Doc. E/CN.4/Sub.2/200/Rev1, U.N. Sales no. 60.XIV.2 (1960), reprinted in 11 N.Y.U.J. Int'l L. & Pol. 227 (1987) Publication, Sales No. 60.XIV.2.

General Comment on Art. 18 of the ICCPR by the Human Rights Committee, CRP.2/Rev.1.20 July, 1993.

Küng, Hans, and Karl-Josef Kuschel, eds. 1993. *A Global Ethic. The Declaration of the Parliament of World's Religions.* Continuum, London.

Marshall, Paul. 2000. *Religious Freedom in the World: A Global Report of Freedom and Persecution.* Broadman & Holman, Nashville, Tenn. Lerner, Natan, 2000. *Religion Beliefs, and International Human Rights.* Orbis Books, New York.

Odio Benito, Elisabeth. Study of the Current Dimensions of the Problem and Belief, U.N. ESCOR 39th Sess., Agenda Item 13, U.N. Doc. E/CN.4/Sub.2/1987/26.

Witte, John J. Jr., and Johan van der Vyver. eds. 1996. *Religious Human Rights in Global Perspectives.* Martinus Nijhoff Publishers, Dordrecht/London/Boston.

Yinger, J. Milton. 1970. *The Scientific Study of Religion.* McMillan, New York.

World Council of Churches- Inter-religious Relations & Dialogue
<http://www.wcc-coe.org/wcc/what/interreligious/indx-e.html>

World Conference on Religion and Peace (WCRP): <http://www.wcrp.org/>

International Consultative Conference on School Education in Relation with Freedom of Religion and Belief, Tolernace and Non-Discrimination in Madrid, November 2001. available online at: <http://www.unhchr.ch/html/menu2/7/b/main.htm>

INFORMATATA PLOTËSUESE

Afhkami, Mahanaz. ed. 1995. *Faith and Freedom: Women's Human Rights in the Muslim World. (Gender, Culture and Politics in the Middle East)*. Syracuse University Press, Syracuse.

Diouf, Sylviane A. 1998. *Servants of Allah: African Muslims Enslaved in Americas*. New York University Press, New York.

Gahrana, Kanan. 2001. *Right to Freedom of Religion: A Study in Indian Secularism*. International Academic Publishing.

Lipton, Edward P. and Bob P. Temple, eds. 2002. *Religious Freedom in the Near East, Northern Africa and the Former Soviet States*. Nova Science Publishers.

Surush, Abd Al-Karim et al. 2000. *Reason, Freedom and Democracy in Islam: Essential Writings of Abdolkarim Suroush*. Oxford University Press.

Annual (United States) Department Report on Internaitonal Religious Freedom:

http://www.uscirf.gov/dos01Pages/irf_exec.php3?mode=print

Anti-Defamation League (ADL): <http://www.adl.org/>

Center for Religious Freedom- A Division of Freedom House:

<http://www.freedomhouse.org/religion>

Council for a Prliament of the World's Religions: <http://www/cpwr.org/>

European Court of Human Rights. Case of Kokkinakis v. Greece from 25 May 1993, available online at:

<http://hudoc.echr.coe.int/hudoc/ViewRoot.asp?Item=2&Action=Html&X=604114335&Notice=O&Noticemode=&RelatedMode=0>

Global Ethic Foundation: <http://www.weltethos.org>

Human Rights Watch: <http://www.hrw.org/religion/>

Human Rights Without Frontiers: <http://hrwf.net/newhrwf/>

International Association for Religious Freedom:

<http://www.iarf-religiousfreedom.net/>

Internatioanl Journal of Philosophy of Religion, Department of Philosophy, University of South Carolina: USA. <http://www.kluweronline.com/issn/0020-7047/contents>

Journal of Religion and Society, Center for the Study of Religion & Society, Creighton University, <http://www.crighton.edu/JRS>

Marburg Journal of Religion, available online at: <http://www.uni-marburg.de/religionswissenschaft/journal/mjr>

Ontario Consultants of Religion Freedoms: <http://www.religioustolerance.org>

Soka Gakki International (SGI) Worldwide Buddhist Association:

<http://www.sgi.org/>

Special Rapporteur of the Commission on Human Rights on Freedom of Religion or Belief: <http://www.unhchr.ch/html/menu2/7/b/mrei.htm>